



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2237 Prot

Lezhë, më 22 / 2 /2023

VENDIM

Nr. 13, datë 21 / 02 /2023

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TEK BASHKIA LEZHË, TË
OBJEKTIT ISH MATERNITETI LEZHË, " PASURIA ME NR 3/51, 3/52 , ZONA
KADASTRALE 8632"

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, " Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 15, nenit 16, të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të Shtetit", të ndryshuar, nenit 3, shkronja gj, nenit 5, të ligjit nr 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, të ndryshuar, ligjit nr.111/2018, "Për kadastrën ", ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe Vendimit nr. 414, datë 11.07.2007, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Lezhë, të Qarkut Lezhë, si dhe pas dhënjes së pëlqimit paraprak të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tek Bashkia Lezhë, të objektit "Ish Materniteti Lezhë", pasuria me nr. 3/51, 3/52 , Zona Kadastrale 8632.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban dhe Drejtoria Juridike.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 , të nenit 55 , të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore ", të ndryshuar .

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 187/11 Prot.

Lezhë, më 27.02.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr 139/2015 "Për vërtetësimin vendore", nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" (ndryshuar me ligjet nr.9558, datë 8.6.2006, nr. 111/2020, datë 29.7.2020), ligjin nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të të Vendimit nr.13, datë 21.02.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë, "Për miratimin e kërkesës për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tek bashkia Lezhë të objektit ish Materniteti Lezhë, pasuria me nr.3/51; 3/52 zona kadastrale 8632".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

